

20151524361

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MUZE

Neni 1

Në Ligjin për muze (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 66/2004, 89/2008, 116/10, 51/11 dhe 88/15) në nenin 45 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

„(2) Gjorbë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t’i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik.”

Neni 2

Në nenin 45-a në paragrafi (1) në fjalinë hyrëse fjalët: “1.000 deri” shlyhen.

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

“(2) Gjorbë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t’i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik.”

Në paragrafin (3) fjalët: „600 deri 700“ zëvendësohen me fjalët: „100 deri 150“.

Neni 3

Neni 45-b ndryshohet si vijon:

Matja e lartësisë së gjorbës për personin juridik bëhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtjet.”

Neni 4

Në nenin 45-g në paragrafin (7) pas fjalës: “organ” shtohen fjalët: “e udhëheq procedurën kundërvajtëse në pajtim me Ligjin për kundërvajtjet dhe”.

Paragrafi (10) ndryshohet si vijon:

“Kundër vendimit për kundërvajtje që e ka miratuar Komisioni Kundërvajtës mund të parashtrohet ankesë te Komisioni Shtetërorë për Vendimmarrje në Shkallë të dytë në sferën e mbikëqyrjes inspektuese dhe procedurës kundërvajtëse.”

Neni 5

Titulli i nenit dhe neni 45-d ndryshohen si vijon:

“Procedurë për dhënien e urdhërpagesës kundërvajtëse

Neni 45 – d

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 45 dhe 45-a nga ky ligj, inspektori për kulturë kryerësit të kundërvajtjes t’i jep urdhërpagesë kundërvajtëse, në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

(2) Nëse kryerësi e pranon urdhërpagesën kundërvajtëse, të njëjtën duhet ta nënshkruaj. Pranimi i urdhërpagesës kundërvajtëse nga kryerësi i kundërvajtjes shënohet në procesverbal.

(3) Në procesverbalin nga paragrafi (2) i këtij neni përcaktohet mënyra në të cilën do të hiqen pasojat e dëmshme nga kundërvajtja, si dhe mënyra e tejkalimit të pasojave nga kundërvajtja e bërë.

(4) Kur si kryerës të kundërvajtjes paraqitet person juridik, procesverbalin dhe urdhërpagesën kundërvajtëse e nënshkruan personi përgjegjës apo personi i autorizuar nga ai.

(5) Inspektori i kulturës është i detyruar të mbajë evidencë për urdhërpagesat kundërvajtëse dhe për rezultatin nga procedurat e ngritura.

(6) Në evidencën nga paragrafi (5) i këtij neni mblidhen, përpunohen dhe ruhen këto të dhëna: emri dhe mbiemri, përkatësisht emri i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi përkatësisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës kundërvajtëse e cila i jepet dhe rezultati i procedurës.

(7) Të dhënat personale nga paragrafi (6) i këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e futjes në evidencën.

(8) Ministri i përcakton formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës kundërvajtëse.”

Neni 6

Akti nënligjorë i përcaktuar me këtë ligj do të miratohet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.